

Vendim nr. 102 datë 10.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 10.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (Gj) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GJET KOLA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 944, datë 27.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 3017, datë 09.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 39, datë 20.01.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-4308, datë 12.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe dy shtetas të tjerë kanë përfunduar një studim fizibiliteti të rrugës Durrës - Morinë dhe projektidenë e përgjithshme të rrugës Durrës - Orosh - Kukës - Morinë. Për këto punime, në datën 27.04.2009, kërkuesi i është drejtuar Këshillit të Ministrave (KM) me kërkesë për përmbushjen e detyrimit kontraktor për pagimin e shpërblimit, kërkesë për të cilën nuk ka marrë përgjigje.

2. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me një padi me objekt detyrimin e KM-së për të nxjerrë aktin (vendimin) që përcakton çmimin e shpërblimit për shërbimin e kryer, realizimin e “Studimit të fizibilitetit të rrugës Durrës - Morinë dhe projektidesë së përgjithshme të rrugës Durrës - Orosh (Reps) - Kukës - Morinë”. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 944, datë 27.01.2014, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3. Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3017, datë 09.06.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se marrëdhënia juridike objekt konflikti ishte marrëdhënie juridike detyrimi dhe jo administrative. Sipas gjykatës, e drejta subjektive e pretenduar nga kërkuesi nuk gjente mbështetje ligjore në atë lloj padie që është paraqitur, por në një me padi me objekt përmbushje detyrimi kontraktor.

4. Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur apel kërkuesi, duke kërkuar prishjen e tij dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, me një tjetër trup gjykues. Nga ana tjetër, Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Tiranë ka paraqitur apel kundërshtues, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 39, datë 20.01.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 3017, datë 09.06.2014, me të njëjtën linjë arsyetimi sikurse gjykata e shkallës së parë.

6. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, ndërsa Avokatura e Shtetit ka paraqitur kundërrekurs. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-4308, datë 12.10.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

7. Kërkuesi në datën 12.02.2024 (*data e shërbimit postar*) i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 11.03.2024 pas plotësimit të dokumenteve.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se:

- 8.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke shpallur moskompetencën, ka mohuar të drejtën e sanksionuar në nenin 54 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), sipas të cilit i takon paditësit të zgjedhë mes gjykatave kompetente. Gjykata e rrethit nuk e ka vënë në dijeni vendimin për shpalljen e moskompetencës, kjo provohet me faktin se vendimi nuk është marrë në seancë gjyqësore dhe ka tentuar parashkrimin e së drejtës së padisë.
- 8.2. Gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është paraqitur kërkesë për të thirrur dhe për të marrë në pyetje disa dëshmitarë. Kërkesa është përsëritur edhe gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit.
- 8.3. Gjatë gjykimit është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:
 - 8.3.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjatë gjykimit në shkallë të parë është kërkuar përjashtimi i gjyqtarit, por kërkesa nuk është pranuar. Gjykata e shkallës së parë është shprehur se vendimi është shpallur në mungesë të paditësit, duke pranuar se e ka paragjykuar çështjen.
 - 8.3.2. *Së drejtës për t'u mbrojtur*, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vijuar gjykimin edhe pse i është paraqitur kërkesë për shtyrjen e gjykimit për shkak të mosparaqitjes së kërkuesit për arsye shëndetësore. Edhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk është njoftuar kundërrekursi i paraqitur nga Avokatura e Shtetit, duke mos pasur mundësi të paraqesë parashtrime.
 - 8.3.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e shkallës së parë, duke lënë të kuptohet se kërkuesi ka marrë pjesë në seancën e fundit, por është larguar gjatë shpalljes së vendimit, ka cenuar edhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Mospranimi i kërkesës për të shtyrë seancën gjyqësore përbën shkelje të rëndë procedurale, pasi i ka mohuar kërkuesit të drejtën për riçeljen e hetimit gjyqësor ose pushimin e çështjes. Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte vendimin duke vlerësuar shkeljen.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Kolegji vlerëson se kërkuesi duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në vështrim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, Kolegji konstaton se, në rastin konkret, kërkuesi, në aspektin procedural formal, ka qenë palë në procesin gjyqësor, por në aspektin substancial, në kërkesën drejtuar Gjykatës, nuk ka parashtruar argumente kushtetuese për të provuar cenimin real të të drejtave dhe lirive themelore të mbrojtura nga Kushtetuta. Kërkuesi në mënyrë që të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje, duhet të provojë se preket në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vendimi gjyqësor objekt kundërshtimi. Në rastin konkret, kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna si rrjedhojë e procesit gjyqësor të nisur nga ai me padi me objekt detyrimin e KM-së për të nxjerrë vendimin për shpërblimin e shërbimit të kryer prej tij, për realizimin e studimit të fizibilitetit të rrugës Durrës - Morinë dhe projektidesë së përgjithshme të rrugës Durrës - Orosh (Reps) - Kukës - Morinë. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk e kanë legjitimuar në ngritjen e padisë, pasi e drejta subjektive e pretenduar nga kërkuesi nuk gjente mbështetje ligjore me këtë padi, por me padi me objekt përmbushje detyrimi kontraktor. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të provojë se cilat janë interesat e tij konkretë që janë prekur nga proceset gjyqësore

të kundërshtuara, të përfunduara me vendimin nr. 00-2023-4308, datë 12.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ai nuk legjitimohet *ratione personae* në kërkesën drejtuar Gjykatës.

12. Në përfundim, Kolegji çmon se në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre dhe se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b” e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.